



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 799/1 Prot.

Tiranë, më 27 . 05 . 2021

V E N D I M

Nr. 88, Datë 27 . 05 . 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 14, datë 18.02.2021¹, të S.A kundër Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës²”, “gjendjes ekonomike³” dhe “gjendjes familjare”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe në e-mail-in datë 08.03.2021, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Ka bërë vetdeklarimin për të legalizuar objektin e ndërtuar pa leje me nr. 1096, datë 22.08.2006. Ankuesi shpjegon se dhe pas 15 vitesh, banesa e tij e ndërtuar në lagjen Yzberisht, Njësia Administrative nr. 6, vazhdon të jetë në proces legalizimi. S.A pretendon se zvarritja e procesit të legalizimit të ndërtesës së tij nga ana e institucionit po bëhet për shkak se i përket komunitetit rom dhe është në gjendje të vështirë ekonomike. Ankuesi informon se persona të tjerë (S.C, H.J, B.C) që banojnë në afërsi të banesës së tij dhe i përkasin maxhorancës kanë marrë lejen e legalizimit”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfundimin e procedurave të legalizimit të ndërtesës së tij.

¹ Ankesa është plotësuar me informacion dhe dokumentacion, me e-mail-in datë 08.03.2021.

² Referuar Vërtetimit datë 08.03.2021 të Shoqatës “Qendra për Advokim Social”, S.A është anëtar i Komunitetit Rom.

³ Referuar Vërtetimit nr. 818, datë 19.02.2021 të Njesisë Administrative Kashar, S.A trajtohet me ndihmë ekonomike.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 5, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas shqyrtimit paraprak të saj, u konstatua se ankesa e depozituar pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me shkresën nr. 282/1, datë 23.02.2021 dhe e-mail-in datë 26.02.2021, institucioni i Komisionerit, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë informacion dhe dokumentacion shtesë.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, ankuesi me e-mail-in, datë 08.03.2021, ka dërguar pranë Komisionerit, shpjegime shtesë dhe kopje të vërtetimit që i përket komunitetit rom.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 282/2, datë 10.03.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale 2 dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion, si më poshtë vijon:
 - Informacion të përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit S.A.
 - Kopje të plotë të praktikës shkresore/procedurës së ndjekur, lidhur me rastin e legalizimit të banesës së S.A.
 - Informacion lidhur me statusin juridik të objekteve të banimit të shtetasve, S.C, H.J dhe B.C të cilët janë pajisur me vendimin për legalizimin e ndërtimit pa leje (kopje të akteve të legalizimit të ndërtesave të tyre).

Me shkresën nr. 1933, datë 29.03.2021, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale 2, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Sipas verifikimit të kryer rezulton se pranë Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, administrohet praktika e legalizimit me vetëdeklarim nr. 1096, datë 22.08.2006, në emër të subjektit S.A. Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të kryer nga specialistët e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Ruralë 2, rezulton se nga përputhja e parcelës ndërtimore me hartën kadastrale që disponon Agjencia Shtetërore e Kadastrës, u konstatua se ndërtesa prek pasurinë nr. 481, Vol. 6, fq. 156, Z.K. 3866, lloji i pasurisë “Rrugë” me sipërfaqe 1300 m², e afishuar “Shtet”. Në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 15/a të VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” ku parashikohet: “Ndërtimi pa leje i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar ose zonës urbane, i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nuk legalizohet nëse verifikohet një nga rastet e mëposhtëme: a) shkel trupin e rrugës ekzistuese të kategorizuar si A, B, C, D, ose E”. Për sa më lart, Drejtoria Vendore e ASHK-së Tirana Rurale 2 nuk mund të vijojë me procedurat administrative të legalizimit për këtë objekt informal”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

Ankuesi S.A është banor në Yzberisht, Tiranë, i cili ka ndërtuar në vitin 2006 një objekt banesë pa leje ndërtimi në Njësinë Administrative nr. 6. Në vijim, ai ka depozituar vetëdeklarimin nr. 1096, datë 22.08.2006, për legalizimin e objektit informal. Ankuesi pretendon se edhe pse kanë kaluar 15 vjet, ai ende nuk ka fituar pronësinë mbi objektin e sipërpërmendur.

S.A pretendon se zvarritja e procedurave për legalizimin e ndërtesës së tij të banimit është diskriminim që atij po i bëhet për shkak të racës rome, gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike. Ankuesi kërkon ndërhyrjen e KMD-së për të përfituar legalizimin e banesës së tij.

Për sa më sipër, rezulton se vetëdeklarimi nr. 1096, datë 22.08.2006, i ankuesit S.A është depozituar pranë Drejtorisë Rajonale të Aluizmit, e cila ka funksionuar deri në vitin 2018, periudhë në të cilën është miratuar ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, nëpërmjet së cilit është krijuar Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila ndër të tjera mori edhe funksionet e ish-Aluizmit. Ndërkohë që, nëpërmjet Urdhërit nr. 470, datë 06.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës “Për përcaktimin e kompetencës së disa Drejtorive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” janë përcaktuar gjithashtu edhe kompetencat e Drejtorive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të cilat do të shqyrtojnë në vijim kërkesat për legalizim të ndërtimeve informale, të cilat ishin ende të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale të Aluizmit.

Në referencë nenit 5, të Ligjit nr. 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK) është institucioni publik që organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kadastrën. ASHK është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe për koordinimin e proceseve në bashkëpunim me institucionet dhe organet e tjera qëndrore shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo ndërmjet strukturave në përbërje të saj, me qëllim përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, rezulton se nga analizimi i dokumentacionit tekniko-ligjor dhe nga përputhja e parcelës ndërtimore me hartën kadastrale që disponon Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ndërtesa informale e ankuesit, prek pasurinë nr. 481, Vol. 6, Fq. 156, Z.k. 3866, lloji i pasurisë “Rrugë” me sipërfaqe 1300 m², e afishuar “Shtet”.

Në nenin 18, të Ligjit nr. 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht:

“1. ASHK-ja kryen procedurat e kualifikimit për legalizim të ndërtimeve pa leje, duke u bazuar në kriteret e moscenimit të:

- a) veprave kryesore të infrastrukturës publike;*
- b) akseve rrugore kombëtare;*
- c) territorit apo funksionalitetit të ndërtesave publike;*
- ç) integritetit të pasurive kulturore materiale, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë;*
- d) territoreve të destinuara për investime strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë;*
- dh) vijës bregdetare, në kuptim të interesit publik në zhvillimin e turizmit.*

2. Ndërtimet pa leje që çenojnë kriteret e mësipërme nuk legalizohen. Ato regjistrohen në bazën e të dhënave vetëm për efekt njohjeje të vlerës së investimit të ndërtimit, sipas parashikimeve në nenin 33 të këtij ligji.

3. Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, kriteret e mësipërme sjellin moslegalizim vetëm për sipërfaqet në tejkallim të lejes së ndërtimit, kur ato janë të ndashme nga ndërtimi me leje. Në rastin kur këto sipërfaqe nuk janë të ndashme, objektet me shkelje të lejes së ndërtimit legalizohen në tërësi.”

Në pikën 15, gërma a), të Vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”* parashikohet shprehimisht: *“Ndërtimi pa leje i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar ose zonës urbane, i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, nuk legalizohet nëse verifikohet një nga rastet e mëposhtëme: a) shkel trupin e rrugës ekzistuese të kategorizuar si A, B, C, D, ose E;”*

Në bazë të nenit 2, pika 2, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 *“Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”*, rrugët klasifikohen si më poshtë:

“Sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale rrugët klasifikohen si vijon:

- A. Autostradë*
- B. Rrugë interurbane kryesore*
- C. Rrugë interurbane dytësore*
- D. Rrugë urbane kryesore*
- E. Rrugë urbane dytësore*
- F. Rrugë lokale”.*

Në këto kushte, për sa kohë që ndërtesa informale, për të cilën ankuesi ka depozituar vetëdeklarim për legalizim, prek pasurinë nr. 481, Vol. 6, Fq. 156, Z.k. 3866, lloji i pasurisë *“Rrugë”* me sipërfaqe 1300 m², e afishuar *“Shtet”*, e cila kategorizohet sipas nenit 2, pika 2 të

Kodit Rrugor dhe pikës 15, gërma a), të VKM nr. 1040/2020, procesi i legalizimit nuk është vazhduar më tej nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se në interpretim të nenit 7, pika 1 të LMD, të ndryshuar, se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues, nuk mund të ketë diskriminim për shkaqet e pretenduara në ankesë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të S.A, për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe gjendjes familjare, nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2, pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA